



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 3, dt. 15.03.2024

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TË VITIT 2023 SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2024

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, si dhe të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit mbi përdorimin e fondeve të vitit 2023, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2023 në vlerë 7748656.94 lekë.
2. Të miratojë shtesë në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024 të të ardhurave të trashëguara në vlerë 7748656.94 lekë.
3. Fondi prej 7748656.94 lekë do të përdoret sipas strukturës buxhetore të mëposhtme:

| | |
|-----------------|---|
| 00/04130/01/602 | 1000000 lekë (Aktiviteti “Sportistët më të mirë të Qarkut”) |
| 00/04130/01/602 | 3000000 lekë (Shkolla e lidershit) |
| 00/06260/01/230 | 1645193.04 lekë (Projekte studimi ne bashkepunim me bashkitë) |
| 00/06260/05/230 | 2103463.9 lekë (Projekte studimi ne bashkepunim me bashkitë) |

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Erjon NEXHIPI
Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi: O. Beqiraj
Juristi: Gj. Kristo
Sekretari: B. Muco





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TË VITIT 2023 SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimeve të Ministrisë të Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 25 datë 22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2024” si dhe të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit mbi përdorimin e fondeve për vitin 2023 dhe trashëgimin e tyre për vitin 2024, ju paraqesim për miratim përdorimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2023 dhe miratimin e shtesës në Buxhetin e vitit 2024 si më poshtë:

Në baze të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit Korçë mbi përdorimin e fondeve të buxhetit të vitit 2023, Këshilli i Qarkut ka trashëguar fonde të papërdorura në vlerë totale 45793080.71 leke. Trashëgimi i këtij fondi nga viti 2023 ka ardhur në disa zëra të cilat janë analizuar në miratimin e buxhetit të vitit 2024. Rreth 13 % të këtyre fondeve janë trashëguar nga fondet e planifikuara për bashkëfinancim për pjesëmarrje në projektet e Bashkimit Europian. Gjatë vitit 2023 janë implementuar 3 projekte të cilat u mbyllën dhe nuk kanë më aktivitete. Diferenca fondesh të papërdorura kemi edhe në zërin investime ku projektet me përfitues Bashkitë e Qarkut, janë prokuruar në vitin 2023 dhe përfundimi dhe financimi i tyre do të bëhet në vitin 2024. Në këtë zë kemi trashëguar rreth 44 % të trashëgimit në total. Kjo ka ardhur si rezultat i mos financimit të rrugës Grunjas –Kakac-Shqitas, për shkak të disa problematikave, e cila do të financohet sivjet. Gjithashtu diferencat kanë ardhur edhe nga ndryshimet midis fondeve limit të përcaktuara dhe vlerave të prokuruar për projektet e investimeve. Pjesa tjetër e trashëgimit lidhet me shpenzimet operative si dhe të ardhurat e realizuara nga Këshilli i Qarkut për vitin 2023.

Nga fondi i trashëguar në total prej 45793080.71 leke, fondi prej 38044423.77 lekë është planifikuar për tu përdorur që në miratimin e buxhetit të vitit 2024. Pjesa e mbetur prej 7748656.94 lekë propozojmë ti shtohet buxhetit 2024 dhe të përdoret e ndarë si më poshtë:

| | |
|-----------------|---|
| 00/04130/01/602 | 1000000 lekë(Aktiviteti “Sportistët më të mirë të Qarkut”) |
| 00/04130/01/602 | 3000000 lekë (Shkolla e lidërshipt) |
| 00/06260/01/230 | 1645193.04 lekë (Projekte studimi ne bashkepunim me bashkitë) |
| 00/06260/05/230 | 2103463.9 lekë (Projekte studimi ne bashkepunim me bashkitë) |

Këto aktivitete do ti shërbejnë rajonit duke nxitur zhvillimin në fusha të caktuara, për të qënë sa më afër me nevojat e komunitetit.

Korçë me 11.03.2024

P.Finance
Oljona Beqiraj